

# UDHËKRYQET E FEMRËS KRIJUESE RRETH VETVETES

Të flasësh përfemrën krijuese në mjeshterin tonë dhe vendin që ajo zë në rrjedhat bashkëkohore të krijimtarisë artistike, nuk është një çështje që duhet të shtrohet, madje të kërkohet që të thuhen diçka më shtruar nga vetë ato, vetëm në kohën e festës së tyre — 8 Marsit. Por, ja, pikërisht kur ndjemë se kjo festë po troket në dyert tona, atëherë si më shumë preokupohemi rreth tyre. Është gjithashtu e vërtetë se bëhen përpjekje të mëdha që ato të përkrahen dhe të afirmohen përfshirë më shumë në çdo kohë. Madje, ato kanë mundësi shumë të mëdha që të mendojnë edhe më shumë rreth vetvetes, ngase ato më së miri do ta vlerësonin pozitën e tyre.

Këtë herë pikërisht përfshirë disa aspekte të pozitës së femrës krijuese në Kosovë dhe përpjekjet preokupimet e tyre krijuese në pasurimin e krijimtarisë artistike biseduan me Fehime Selimin (poete) dhe Vesta Nurën (piktore dhe njëherit gazetare në sektorin e artit figurativ në gazeten «Rilindja»).

**FEHIME SELIMI:**

## MË BRENGOS HESHTJA E SHOQEVE

Kohët e fundit fare pak femra po i përkushtohen krijimtarisë letrare, gjë që s'më vjen aspak mirë, sepse sot e gjithë ditën mendoj se cilësia kërkohet në sasi, e ç'cilësi e vlerave ideoartistike të kërkohet aty ku defilojnë pesë—gjashtë emra krijuesesh që merren më seriozisht me këtë punë. Pra, ato sot mund të numërohen në gishtërinj. Shumë prej këtyre femrave që e trasuan të parat këtë rrugë, krijuan familje dhe gradualisht të hutuar nga përditshmëria heshtën. Më brengos heshtja e këtyre shoqeve, por njëkohësisht i gëzohem paraqitjes së çdo emri të ri, gjithnjë me dëshirë që midis tyre të lindë një Adelinë, një Elena Kadare apo një Natasha Lako. Dhe pse jo, unë thellësisht besoj se kemi talent, por me to duhet të punohet dhe të përkrahen dhe një herë e përgjithmonë të thyhet botëkuptimi se femra nuk mund të krijojë vlera po aq të rëndësishme sa edhe mashkulli. Në një bisedë njëra prej shoqeve që dikur shkruante më tha se të

përkundësh djepin është poezi më vete. Pajtohem plotësisht me të, por më duhet të them se është poezi përfshirë cilën gjithsesi duhet të shkruhet një tjetër poezi, pra poezi përfshirë e saj të jetës. Them kështu sepse 12 përbledhje poezish janë shumë pak përfshirë dyzet e sas të krijimtarisë në liri, e të mos flasim përfshirë prozën e shkruar nga femra jonë, përfshirë cilën, siç tha një krijues yni, sot e atë ditë ka mbetur «thembër Akili» në letrat tona.

Përndryshe, edhe unë si krijuese jam përpjekur që ta jap kontributin tim. Në vargjet e mia jeton një femijëri e derdhur rrugëve të vendlindjes, një botë e largët e prapë aq e afërt që evokohet përmes kujtimeve, një kohë përplot rrëfime që jetojnë në formë fatesh e tregimesh te Kthyera' gati në legjendë, që në poezinë time marrin fyrme përmes simboleve. Gjyshi, kulla e lumi, një lumë që rrjedh pandërprerë e simbolizon vazhdimesinë e revolucionit deri në ditë tona — janë simbole që flasin përfshirë kaluarën e largët e të afërt në emër të së nesërmes, që flasin përfshirë dashuri që vazhdon e s'ndalet si jeta... Në vargun tim fyrmezimi del si dicë që duhet të thu-

Nr. 10  
10 mars 1984



**Fehime Selimi, poete**

het pa tjetër, sepse mendoj se momenti i fyrmezimit të singertë s'mënyra e transponimit të këtij fyrmezimi është komponenta kryesore e aktit të krijimit. Ky fyrmezi është shqetësimi i brendshëm që duhet poetit, vlimi shpirtëror, lufta hapur me vetveteren — nga e cila lidhi vargu si pasojë. Përfshirë ato shkruajt nga një këndvështrim posaçëm, ta quaj ashtu «femëror». Në përbledhjen time më të re nuk cikël i tërë i kushtohet femrës së nepër kohë, sakrificës dhe vetëm himit të saj përfshirë një të ardhme më mirë.